



## Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

### **Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH**

■ Në kuadër të programit të MKLSH, më 29-30 shtator 2007 është mbajtur seminari i tretë "Leximi, shkrimi dhe diskutimi në çdo lëndë" në 9 qendra të Kosovës, në Prishtinë (2 grupe), në Prizren (2 grupe), Gjakovë, Drenas, Shtime, Mitrovicë dhe Gjilan. Seminari i tretë nuk është mbajtur në Klinë për shkak të pjesëmarrësve të cilët kanë qenë në një ekskursion. Ky seminar do të mbahet më 6-7 tetor 2007. Pjesëmarrja në seminar ka qenë e rregullt dhe trajnerët kanë raportuar se çdo gjë ka shkuar sipas planifikimit. Mësimdhënësit në fund të seminarit janë njoftuar se gjatë muajit tetor ata do të monitorohen në klasat e tyre, ndërsa më 27 tetor do të organizohet një takim gjysmë ditor ku do të diskutohen orët e monitoruara.

■ Gjatë 22-24 shtator në lokalet e Qendrës Didaktike në Gjakovë është mbajtur seminari i 4 & 5 në kuadër të MKLSH-së për mësimdhënësit e shkollave "M. Këpuska", "F. Agani", "Zekerija Rexha" dhe "Zef Lush Marku" të Gjakovës. Modulet që u zhvilluan gjatë këtij seminarit ishin: Të nxënësve në bashkëpunim, Nga të vetë shprehurit tek argumentet e shkruara, si dhe Krijimi i lexuesve mendimtarë. Seminari vërtetoi që pjesëmarrësit kanë fituar njohuritë e nevojshme për zbatimin e filozofisë së MKLSH-së në klasat e tyre. Pjesëmarrësit u njoftuan se monitorimi i tyre në klasa do të bëhet në periudhën 1-15 tetor.

### **Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin**

■ Në 18-19 shtator 2007 në sallën e Kuvendit Komunal në Ferizaj është mbajtur seminari "Edukimi, themelimi dhe monitorimi i strukturave që luftojnë korrupsionin". Në këtë seminar morrin pjesë 23 përfaqësues të Kuvendit Komunal të Ferizajit, drejtorë të shkollave, si dhe përfaqësues të OJQ dhe mediave. Gjatë seminarit mbretëroi një atmosferë e mirë pune.



### **Edukimi për të Drejtat e Fëmijës**

■ Në kuadër të këtij projekti, gjatë këtij muaji janë organizuar dy aktivitete me nxënës të shkollës jopublike "Mileniumi i Tretë". Dita e paqes, është ditë të cilën e kanë shënuar nxënës të kësaj shkolle së bashku me mësimdhënës të tyre. Si aktivitet të veçantë, përveç punimeve të artit dhe eseve të ndryshme, mësimdhënës të tyre kanë mundësuar nxënësve të shikojnë një film për edukim dhe jetesë në paqe me fëmijët e

të gjitha komuniteteve. Pas filmit, nxënësit kanë pasur rast të komentojnë dhe të debatojnë në lidhje me filmin.



■ Po ashtu, tre nxënës nga shkolla "Mileniumi i Tretë", kanë fituar shpërblime nga kompania Rrota, e cila i ka shpërblyer nxënësit për punimet më të mira me Hieroglifë. Nxënësit fitues janë: Rozafa Maliqi e shpërblyer me një Game Boy (çmimi i parë) ; Çmimi i dytë me Dvd player të cilën e fitoi Ardian Pllana dhe Çmimi i Tretë Yllka Pllana e cila fitoi një Sony Mp3 Player.

## **Edukimi Multikulturor dhe Multietnik**

■ Në kuadër të këtij programi kanë filluar trajnimet e mësimdhënësve në disa qendra të Kosovës.

Janë mbajtur trajnimet tre ditore në Pejë, Gjakovë dhe Mitrovicë. Pjesëmarrësit e këtij trajnimi kanë qenë mësimdhënësit të cilët janë certifikuar për këshilltarë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës sipas programit "Edukimi për të Drejtat e Fëmijës".

Në fund të trajnimit të gjithë pjesëmarrësit u ndanë shumë të kënaqur.



■ Më 27 shtator, në Gjilan është organizuar nja aktivitet social me nxënës të komuniteteve turke dhe shqiptare. Aktiviteti është bërë me 22 fëmijë të shkollës fillore "Musa Zajmi në Gjilan, të cilët së bashku me organizatoren e këtij aktiviteti kanë vizituar Kalanë e Pograxhës. Në kala, fëmijët janë njohur më afër me historinë e kësaj kalaje. Ligjërues-cicëron në këtë aktivitet ishte Remzi Ahmeti-profesor i historisë. Nxënësit gjatë ditës kanë pasur edhe disa aktivitete-lojëra për edukim Multikulturor dhe Multietnik.

## **Hap pas Hapi**

■ Në kuadër të programit Hap pas Hapi është organizuar trajnimi për klasën e dytë në Pejë. Ky trajnim u mbajt nga data 27-29 shtator.

Trajnimi ka shkuar shumë mirë, të gjithë pjesëmarrësit janë ndarë të kënaqur. Këto dy grupe do të vazhdojnë me trajnimet e radhës, të cilat pritet të mbahen në muajt e ardhshëm.

■ Në vazhden e aktiviteteve të programit Hap pas Hapi, rol të veçante kanë edhe monitorimet te klasat që zbatojnë këtë metodologji.

Në kuadër të kësaj, ka filluar monitorimi sipas planit të paraparë. Monitorimi do të

bëhet për klasat e shkollave fillore si dhe klasat e grupmoshave të institucioneve parafillore, të cilët realizojnë metodologjinë Hap pas Hapi

### **Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim**

■ Në kuadër të këtij projekti “Shoqëria civile për pjesëmarrje të shtuar në arsim” të financuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim, nga data 26-28 shtator, në lokalet e KEC u mbajt trajnimi “Avokimi për politikën”. Trajnere ishte Katalin Pallai nga Hungaria. Pjesëmarrës në trajnime ishin përfaqësues të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit dhe Shkencës (SBASHK), Shoqatës Kosovare për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijës (KAHCR), dhe Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC), të cilët edhe më parë ishin të përfshirë në aktivitetet e projektit.



Nga SBASHK morën pjesë edhe 10 përfaqësues të rinj në cilësi të trajnerëve të cilët pritet në të ardhmen të organizojnë trajnime për “Avokimin e politikave” siç është paraparë në projekt.

### **Edukimi për të drejtën shoqërore**

■ Programi “Edukimi për të Drejtën shoqërore” i financuar nga Banka Botërore është duke u zhvilluar sipas dinamikës së projektit.

Në kuadër të këtij projekti, kanë filluar edhe monitorimet e shkollave të cilat janë pjesë e projektit, pra, shkollat të cilat do të organizohen aktivitetet sociale. Është vendosur

që aktiviteti i parë social të fillojë me komunën e Pejës, të cilët do të organizojnë një tryezë të rumbullakët me nxënës të komuniteteve të ndryshme. Kanë filluar edhe përgatitjet për këtë aktivitet dhe planifikohet që tryeza e rumbullakët të mbahet më 15 tetor të këtij viti.

Po ashtu planifikohet që edhe komuna e Gjakovës këtë muaj të organizojë një aktivitet të tillë.

*Përgatiti: Petrit Tahiri*